



BIO

Diplomuar në Middlesex University, Athinë, BsC. me rezultate të shkëlqyera në “3D Animation and Multimedia Production” me një dizertacion mbi video game dhe real time rendering.

Më tej, mbron Masterin shkencor në “Dizajn të Aplikuar” në Universitetin Polis, Tiranë, me temë mbi Konceptimin dhe strukturën e TV commercials dhe prodhimin e tyre me kosto të ulët. Ka mbrojtur doktoraturen pranë Universitetit të Ferrarës, Itali, në programin ndërkombëtar të doktoraturës në Fakultetin e Arkitekturës.

Fokusi i temës së doktoraturës është hapësira virtuale (metaverse) në arkitekturë dhe video game.

Në fushën akademike ka një eksperiencë mjaft të gjatë. Në vitet 2008-2010, ka qenë lektor dhe drejtues departamenti pranë Akademisë së Filmit & Multimedias Marubi. Në vitet 2013-2020 ka qenë lektor pranë departamentit të Artit dhe Dizajnit në Universitetin Polis. Fushat e mbuluara në nivel akademik kanë qenë: Film/Video, Efekte Vizuale, Editing/ Post Production, Advertising, Modelim 3D, Animacion 2D dhe 3D dhe Arte Digjitale. Në këto 12 vite mësimdhënie ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme në fushën e Multimedias dhe Dizajnit si dhe ka organizuar disa workshope mbi videoart dhe ekspozita me punë studentore. Gjithashtu, ka një sërë publikimesh dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore në fushën e realitetit virtual.

Joan Ikonomi ka një eksperience mjaft e gjatë profesionale në fushën e advertising. Ai ka punuar si manager post-produksioni në kompaninë e reklamave “Le Spot”, fillimisht në Athinë e më pas në Tiranë. Po ashtu ka punuar si manager produksioni në televizion, ka bashkëpunuar në 2 filma kinematografik, dhe si profesionist i lirë ka realizuar mbi 100 TV commercial të publikuara në media të ndryshme. Aktualisht merret me projekte kërkimore në lidhje me realitetin virtual, video game, virtual heritage si projekti Smart Tour.

JOAN IKONOMI PHD.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I KARRIERËS

PHD. Joan Ikonomi është lektor i disa lëndëve në Universitetin Barleti si dhe specialist projekti i Institutit për Kërkim dhe Zhvillim “Barleti” BIRD.

FUSHA E EKSPERTIZËS KËRKIMORE

- Multimedia

EMAIL

j.ikonomi@umb.edu.al